



Konferenca e 6-të Ndër-Evropiane e Brezit të Gjelbër 2012

Brezi i Gjelbër Evropian Kufijtë ndajnë. Natyra bashkon!

Përgjatë ish Perdes së Hekurt, e cila ndanë kontinentin evropian në Lindje dhe Perëndim për gati 40 vjet, është zhvilluar një rrjet i shkëlqyeshëm ekologjik dhe një peizazh i gjallë përkujtimor. Pavarësisht mizorisë së saj, zona kufitare i ka dhënë natyrës një pauzë për frymëmarrje përgjatë më shumë se 12,500 kilometrave nga Deti Barents në kufirin Ruso-Norvegjez, përgjatë bregut të Baltikut, nëpër Evropën Qendrore dhe përgjatë Ballkanit e në Detin e Zi. Evropa dikur e ndarë padashur ka mbështetur ruajtjen dhe zhvillimin e habitateve të vlefshme. Zona kufitare ka shërbyer si një strehimore për shumë specie të rrezikuara. Në vitet 1970-ta në disa zona të Europës, ambientalistët u koncentruan në lulëzimin e natyrës dhe kafshëve të egra që ishin duke u përhapur të pashqetësuar. Themelimi i Iniciativës së Brezit të Gjelbër Evropian në vitin 2003 ishte një bashkim i iniciativave të ndryshme ekzistuese rajonale në një iniciativë Evropiane. Sot Brezi i Gjelbër lidh 24 vende, është shtylla kurrizore e një rrjeti ndër-evropian ekologjik dhe kontribon fuqishëm në "Infrastrukturën e Gjelbër" Evropiane. Ajo është një simbol për bashkëpunimin ndër-kufitar dhe një trashëgimi e përbashkët natyrore dhe kulturore evropiane. Rëndësia e madhe e korridorit ekologjik është e dukshme: 40 parqe kombëtare gjenden direkt përgjatë Brezit të Gjelbër Evropian. Më shumë se 3,200 zona të mbrojtura të natyrës mund të gjenden brenda një zone neutrale 50 kilometra në të dyja anët e Brezit të Gjelbër. Ajo kalon nëpër pothuajse të gjitha rajonet bio-gjeografike evropiane.



Informata në lidhje me Brezin e Gjelbër të Evropës mund të merren nga:



Koordinatorët Rajonal

Brezi i Gjelbër Fenoskandik
Baltic Fund for Nature
bfn@bfn.org.ru • www.bfn.org.ru



Norvegji
Bjørn Arne Næss, Miljødirektoratet
bjorn.arne.nass@miljodir.no



Finlandë
Tapio Lindholm, Syke
Tapio.lindholm@ymparisto.fi

Aimo Saano, Metsähallitus
aimo.saano@metsa.fi

Brezi i Gjelbër Baltik
BUND Mecklenburg-Western Pomerania
coordinator@balticgreenbelt.de
www.balticgreenbelt.de



Brezi i Gjelbër i Evropës Qendrore
BUND Project Office Green Belt
greenbelt@bund-naturschutz.de
www.gruenesband.info

Brezi i Gjelbër Ballkanik
EuroNatur
greenbelt@euronatur.org • www.euronatur.org

EURONATUR



Mbështetur nga Agjencioni Federal Gjerman për Mbrojtjen e Natyrës / Ministria Federale e Mjedisit e Gjermanisë, Mbrojtja e Natyrës dhe Siguria Nukleare
www.bfn.de

Botimi i 1-rë, 2013 • Shtypur 100% në letër të ricikluar

Dizajni
Fotot

HGS5 gmbh, Fürth/Germany • www.hgs5.net
Z. Brajanoski, J. Flachs, F. Henkel, E. Körner, J. Peltomäki, Macedonian Ecological Society, Museum Mödlareuth/A. Schaffner, H. Schlumprecht, J. Schmiedel, W. Sollberger, Ch. Übl, W. Willner.

Vula



europian
greenbelt



Brezi i Gjelbër Evropian

Kufijtë ndajnë. Natyra bashkon!

Ariu i Murrme, Finland-Russia



Bregu i detit Baltik



Lilium albanicum, Maqedoni-Shqipëri

Brezi i Gjelbër Evropian përfshin katër rajone organizative: Fenoskandik, Baltik, Evropë Qendrore dhe Ballkanik. Drejtimi i përgjithshëm bëhet nga një grup koordinimi me anëtarë nga të gjitha rajonet. Çdo seksion koordinohet nga një koordinator rajonal dhe në çdo shtet Pikat Kontaktuese Kombëtare janë personat e ngarkuar.

Brezi i Gjelbër i Fenoskandisë – Zingjir një milion hektarësh i rezervave natyrore

Brezi i Gjelbër i Fenoskandisë është një brez territori që shtrihet 1,350 kilometra përgjatë kufijve të Norvegjisë, Rusisë dhe Finlandës nga Barentsi në Detin Baltik. Ky është një Brez i egër. Pjesa veriore është e dominuar nga likenet, myshqet dhe shkurret e vogla. Pjesa qendrore dhe ajo jugore përbëhen nga pyje halore të veriut. Këto kanë shërbyer si strehim për gjitarët e mëdhenj si ariu i murrme dhe dreri. Ligatinat e panumërta, moçalet dhe liqenjtë karakterizojnë peisazhin. Ato ofrojnë habitate të mbarështimit të shpendit kombëtar të Finlandës, mjellmës (cygnus cygnus). Një Memorandum i Mirëkuptimit për bashkëpunim mbi zhvillimin e Brezit të Gjelbër të Fenoskandisë është nënshkruar në shkurt të vitit 2010 nga ministrat e mjedisit të tre vendeve. Kjo lehtëson bashkëpunimin e qëndrueshëm ndër-kufitar në marrëdhënien shoqërore ekologjike dhe ekonomike.

Brezi i Gjelbër Baltik – Brezi bregdetar

Brezi i Gjelbër Baltik shtrihet përgjatë bregdetit të Detit Baltik. Habitete të ndryshme detare nënujore dhe një vijë bregdetare mjaft e larmishme me fusha të dunave të mëdha, plazhe të gjata, shkëmbinjë mbresëlënës dhe laguna të izoluara janë unike për këtë pjesë të Brezit të Gjelbër Evropian. Zona të gjera ushtarake kanë shërbyer si rezerva për miliona zogj



Vidra e Lumit



Rrëqebulli

shtegtarë dhe shumë kafshë detare si'ç janë fokat. Por, që nga vitet 1990 brigjet kanë përjetuar presion të rëndë për zhvillimin dhe shfrytëzim. Ruajtja e aseteve të vlefshme natyrore dhe historike e këtij peisazhi tërheqës dhe shumë të kërkuar përbën një sfidë të madhe për Brezin e Gjelbër.

Brezi i Gjelbër i Evropës Qendrore – Peisazhet e shumëllojshme

Brezi i Gjelbër kalon nëpër një shumëllojshmëri të peisazheve kulturore, pjesërisht të përdorura intensivisht nga bujqësia. Ajo kalon masivin Bohem me parqet e saj kombëtare ndër-kufitare të pyllëzuar mirë si Pyjet Bavarez, ndjek rrjedhat e lumenjve natyror si'ç janë Mura dhe Drava. Ajo kalon nëpër kreshtën e gjatë të Maleve Karavanke dhe Alpeve Juliane duke përfunduar në detin Adriatik. Nëpërmjet mbështetjes së shteteve fqinje në nivele rajonale dhe kombëtare dhe financimit nga BE, akterët përgjatë Brezit të Gjelbër kanë zbatuar dy projekte shumëkombëshe. Qëllimet kryesore janë mbrojtja e Brezit të Gjelbër si një korridor ekologjik dhe peisazh përkujtimor, zhvillimi i bashkëpunimit ndër-kufitar dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

Brezi i Gjelbër Ballkanik – Brezi malor

Pjesa më jugore e Brezit të Gjelbër Evropian përmban një pikë kyçe të biodiversitetit dhe endemizmit. Vendosur kryesisht në vargmalet e



Kampanja Evropiane për Brezin e Gjelbër "Malsch/Malše", Austri-Republika e Çekë



Bretkoca e pemës

Gadishullit Ballkanik, ajo përbën një mozaik jashtëzakonisht heterogjen të peisazheve natyrore duke përfshirë ekosistemet e pacenuara alpine, pyjet, habitatet stepë si dhe liqenet dhe zonat bregdetare. Përveç kësaj, ka peisazhe të jashtëzakonshme kulturore të zhvilluara me një numër bimësh dhe speciejsh të rrezikuara të kafshëve. Mbi kodrat e lëmuara të Sakarit përgjatë kufirit ndërmjet Bullgarisë dhe Turqisë fluturon shqiponja imperiale. Zonat e largëta kufitare dhe pyje të mëdha janë shtëpi për kafshët e turpshme si rrëqebulli Ballkanik.

Brezi i Gjelbër në Kosovë kufizohet me Maqedoninë përgjatë Maleve të Sharrit, me Shqipërinë përgjatë Koritnikut dhe Pashtrikut dhe me Malin e Zi nga Bjeshkët e Nemuna.

Rrëqebulli Ballkanik është specie e rëndësishme së lartë. Në fakt, në Kosovë sa e kemi filluar projektin mbi "Programin e Rimëkëmbjes së Rrëqebullit Ballkanik". Synimet kryesore janë: ndalimi i rënies së mëtejshme të popullsisë së rrëqebullit të Ballkanit dhe për të siguruar mbijetesën e tij në zonat e mbrojtura të Brezit të Gjelbër; për të ndërtuar kapacitetet e nevojshme profesionale për mirëmbajtjen e këtij programi afatgjatë në rajon; dhe për të krijuar një atmosferë të favorshme për ruajtjen e natyrës nëpërmjet partneritetit të ngurta, ndërgjegjësimit publik dhe përfshirja. Kosova ka parqe të rëndësishme kombëtare si'ç janë Bjeshkët e Nemuna në Kosovën Perëndimore që kufizohen me Malin e Zi dhe parku kombëtar Sharr i cili është shpallur në vitin 1993 brenda 39,000 hektarësh në jug të Kosovës, ndërsa kohëve të fundit është zgjeruar më tej.